



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 76, datë 15.06.2020

PËR

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA BANK” SH.A., PËR TË USHTRUAR
VEPRIMTARI BROKERIMI NË SIGURIME, NË KLASAT E JETËS DHE JO-JETËS,
SI DHE BROKERIT FIZIK NË EMËR E PËR LLOGARI TË SAJ**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e shoqërisë “Tirana Bank” sh.a., për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime, në klasat e Jetës dhe Jo-Jetës.
2. Licencimin e zj. Olta Mahja për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime në klasat e Jetës dhe të Jo-Jetës, për një periudhë pa afat, në emër e për llogari të shoqërisë “Tirana Bank” sh.a.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE